



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:068364  
Datë: 16.12.2024  
Numri i dokumentit: 06600235

C-III-16-0049

Paditësja; V M B nga fshati S Komuna e Suharekës, përfaqësuar nga avokati D F nga Suhareka

Kundër

E paditur; NBI Suhareka me seli në Suharekë e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit kryesues; Asllan Krasniqi dhe gjyqtarët anëtar; Agron Hoxhaj dhe Bajram Miftari, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën; 16.12.2024, merr këtë;

**A K T V E N D I M**

Padia e ushtruar nga V M B nga fshati S Komuna e Suharekës konstatohet e tërhjekur.

Rrethanat faktike dhe procedurale;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën; 09.12.2024, ka pranuar një parashtrësë të hartuar me shkrim nga i autorizuari i palës paditëse avokati D F, me të cilën është konstatuar tërhjekja e padisë së ushtruar me datën; 19.07.2007, ndërsa në seancën e mbajtur me datën; 11.12.2024 i autorizuari i palës paditëse nuk ka prezantuar në seancën dëgjimore, për çka edhe gjykata ka vlerësuar se i njëjti ka mbetur pranë parashtrësës së hartuar me shkrim të datës; 09.12.2024 për tërhjekjen e padisë.

Arsyetimi ligjor;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke iu referuar dispozitës së nenit 261 paragrafi 1,3 dhe 5 të LPK-së ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike; Ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Asllan Krasniqi; Gjyqtari kryesues

Agron Hoxhaj;Gjyqtar anëtar dhe

Bajram Miftari;Gjyqtar anëtar